



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 381 Prot.

Gjirokastrë, më 23.03.2023

Lënda: Thirrje për projekte kërkimore –shkencore

Universiteti i Gjirokastrës në kuadër të misionit të tij për mbështetjen e kërkimit shkencor shpall Thirrjen për aplikime për projekte kërkimore shkencore, ku ftohen personel akademik me kohë të plotë nga të tre fakultetet, të cilët janë të interesuar të angazhohen për të kontribuar në fushën e kërkimit.

Thirrja për Aplikime do të qëndrojë e hapur prej datës **23 Mars 2023** deri më **29 Mars 2023 ora 16:00!**

Nën këtë thirrje të gjithë aplikantët duhet të depozitojnë projekt propozimet pranë Zyrës së Marrdhënieve me Jashtë brenda afatit të përcaktuar duke përfshirë edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Dokumentin e përshkrimit të detajuar të projekt propozimit;
- Dokumentin që detajon buxhetin e parashikuar për projektin;
- Cv-në e personave të parashikuar të angazhohen në kërkim.

Komisioni i vlerësimit ad hoc në nivel institucional do të shqyrtojë projekt propozimet dhe do të shpallë 1 (një) projekt fitues për secilin fakultet që ka aplikuar.

Zv / Rektor

Prof.asoc. Merita ISARAJ

